

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Geom International” shpk**

1) Sot, më datë 22/06/2024, u themelua një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ **Geom International** ” shpk.

2) Themeluesi i shoqërisë është:

**Z. Sinan Thaqi**, atësia Idriz, shtetas Kosovar, identifikuar me ID me nr. ID1534811, i datëlindjes 16/09/1990 lindur në Kosove dhe banues në Prishtinë rruga Hajrullah Avdullahu, 10000 Prishtinë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “**Geom International**” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:  
Objekti**

1) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e mëposhtëm:

Aktivitet në fushën e projektimit dhe ndërtimit të objekteve civile, industriale, rruga, ura dhe të ngjashme me këto. Pjesë e veprimtarisë është dhe operimi i infrastrukturës për prodhimin e energjisë elektrike, duke përfshirë projektimin, ndërtimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të energjisë elektrike. Konsulencë për menaxhimin e projekteve dhe mbështetje për licencimin dhe zbatimin e rregullave dhe lejeve të nevojshme në sektorin e energjisë. Shërbime të specializuara në fushën e energjisë alternative dhe tërheqjen e investimeve për zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të vet si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.



#### **Neni 4:**

##### **Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndertesa 3, Hyrja 11, Ap. Nr.2, Tirana 1001.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

#### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë dhe është i përbërë nga 1 (nje) kuote. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:  
A. Ortakët themelues:  
  
- **Sinan Thaqi**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

#### **Neni 6**

##### **Organi Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj

#### **Neni 7**

##### **Administratori**

- 1) Administratorë të shoqërisë emërohet :  
  
**Z. Sinan Thaqi**, atësia Idriz, shtetas Kosovar, identifikuar me ID me nr. ID1534811, i datëlindjes 16/09/1990 lindur në Kosove dhe banues në Prishtinë rruga Hajrullah Avdullahu, 10000 Prishtinë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### **Neni 8**

##### **Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimit dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimit, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë



**Neni 9**

**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKU**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Geom International” shpk**  
**Sinan Thaqi**

SINAN THAQI

